STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 12 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) DHE GUVERNATORI KRISTI (CHRISTIE) NJOFTOJNE RIHAPJEN E STACIONIT TE PATH NE 9TH STREET

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) dhe Guvernatori i Nju Xhërsit Kris Kristi (Chris Christie) njoftuan sot se shërbimi hekurudhor i PATH do të rifillojë në stacionin e 9th Street në Manhatan (Manhattan) duke filluar të martën, 13 nëntor, në 5 të mëngjesit. Stacioni do të hapet për të lehtësuar mbushjen mjaft plot në stacionin e 14th Street gjatë orëve të pikut të mëngjesit.

Udhëtarët e PATH do të jenë në gjendje të dalin nga stacioni i 9th Street vetëm gjatë orëve të pikut të mëngjesit nga 5 në mëngjes deri në 9:30 në mëngjes. Pas 9:30 në mëngjes, pasagjerët do të jenë në gjendje të hyjnë dhe të dalin nga trenat e PATH në 9th Street deri në 10 pasdite.

Linja e përkohëshme e PATH tani do të përfshijë ndalesa në stacionet Njuërk (Newark), Herrisën (Harrison), Xhërnël Skuer (Journal Square), Grove Street (Grove Street) dhe Njuport (Newport) në Nju Xhërsi dhe stacionet në 9th, 14th, 23rd dhe 33rd Street në Manhatan (Manhattan). Trenat nuk do të ndalojnë në rrugët Kristofër (Christopher). Pasagjerët me pa-aftësi do të kënë mundësinë e përdorimit të platformave vetëm në Njuërk (Newark), Xhërnël Skuer (Journal Square) dhe 33rd Street.

Shërbimi i PATH mbetet i pezulluar në stacionet e Hobokenit (Hoboken), Eksçejnxh Plejs (Exchange Place) dhe Qendrës Botërore Tregtare (World Trade Center) ndërsa vazhdojnë përpjekjet e rimëkëmbjes. Për shkak të dëmit të konsiderueshëm që rezultoi nga përmbytja e pashembullt dhe e përhapur gjerë në tunele dhe shumë stacione të PATH, do të duhen disa javë përpara rifillimit të shërbimit në linjën Njuërk-Qendra Botërore Tregtare (Newark-World Trade Center) dhe linjat në dhe nga stacioni i Hoboken.

Për informacion të azhornuar vizitoni faqen në internet të Autoritetit
Portual http://www.panynj.gov/path/ dhe ndiqini ata në Twitter @PATHTweet.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian